


Rezultate kryesore nga hulumtimi anketues për gjendjen me korrupsionin në vitin 2019


Gjatë periudhës prej 16 deri 28 janar 2019 ishte zhvilluar hulumtim anketues në teren me 1004 të anketuar si mostër përfaqësuese të popullatës me moshë të plotësuar në vend. Anketa është zhvilluar nga Brima ndërsa rezultatet janë renditur sipas veçorive demografike.

Korrupsioni është një praktikë e shpërndarë gjerë, duke marrë parasysh deklaratat e të anketuarve. Së paku secili i anketuar i pestë ka raportuar që ka person të afërt që ka dashur të jep dhuratë, rryshfet ose të gjejë lidhje në fushat vijuese: arsim, gjyqësor, polici, gjatë punësimit ose sigurimit të shërbimit shëndetësor. Në fillim të vitit 2019, gjendja ka qenë më tepër e shprehur në shëndetësi, ndërsa më pak e shprehur në arsim dhe gjyqësor.




I kemi pyetur të anketuarit, në shkallë prej 1 deri 10 të vlerësojnë nivelin e rryshfetit dhe favorizimit të fushave vijuese. Sipas pritjeve, me notë mesatare prej 8, në vendin më të lartë gjendet punësimi në institucionet shtetërore, ndërsa menjëherë, vijon dogana, gjyqësori, lejet për ndërtim dhe prokurimet publike. Prej gjithsej 12 fushave, nuk ka fushë në të cilën nota mesatare është nën pesë, ndërsa në rendet


më të lartë gjenden ndihma shtetërore për fermerët dhe akomodimi në konviktet studentore me notat 6.6 dhe 6.5.



Prej të anketuarve që kanë pasur përvojë me institucionet e theksuar më poshtë kemi kërkuar mendim për mundësinë që qytetarët të marrin shërbimin përkatës sipas procedurës së rregullt. Për dallim nga pyetja e mëhershme, këtu institucionet tatimore janë prej tyre më pak të përmendur në të cilat për më shumë se gjysma e të anketuarve pohojnë që ka siguri të lartë që të merret shërbimi përkatës. Institucionet arsimore gjenden më lartë, në të cilat më pak se 60% e të anketuarve kanë theksuar që është e mundshme që të merren shërbime përkatëse. Në mesin e institucioneve të notuar më ulët janë gjykatat, në të cilat 34% e të anketuarve që kanë pasur përvojë me këto institucione kanë thënë që ka mundësi të merret shërbimi përkatës.



Kjo përvojë e qytetarëve kontribuon për perceptimin e gjerë që në shoqërinë tonë ka nevojë për lidhje për gjithçka. Andaj, në shkallë prej 1 deri 10, 48% e të anketuarve tërësisht pajtohen me këtë deklaratë (notë 10).



Këto rezultate tregojnë për rrënjëzim të perceptimeve për përhapje të korrupsionit. Këto perceptime nuk dalin vetëm nga njoftimet e mediave në lidhje me korrupsionin, por sipas të anketuarve, janë konfirmuar me anë të përvojës së tyre të drejtpërdrejtë, gjegjësisht përvojë e të afërmeve të tyre.

Nga kjo, perceptimet ndryshojë me punë të gjatë të institucioneve për të parandaluar korrupsionin. Me anë të mekanizmave të zhvilluara kundër korrupsionit në nivel të institucioneve dhe zbatim të rregullave do të ulen rreziqet e paraqitjes së korrupsionit. Megjithatë, me e rëndësishme është që të përmirësohet denoncimi i korrupsionit, posaçërisht nga ana e të punësuarve, sepse ato pak persona që keqpërdorin institucionet për dobi private, e shkatërrojnë përshtypjen për procese të plota, si gjykatës, polic, mjek, mësimdhënës ose doganier.

* Ky dokument është prodhuar nga ekip i Platformës së Organizatave Qytetare për Luftë kundër Korrupsionit me mbështetjen e popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.